



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:177334

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05518551

P.nr.289/

21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Arlind Sharani, me zyrtarin ligjor Amar Hoxha, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.M., nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.2033-3/20, të datës 09.03.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 27.03.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Musli Gashi, të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 28.03.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.M., nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur menë Prizren, ku edhe tani banon në lagjen “.....” rr. “.....” p.nr., i martuar-baba i 1 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, furrtar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër të letërnjoftimit,

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë 24.09.2020, rreth orës 12:45 min, në Prizren, në rrugën “Jeta e re”, saktësisht te rruga Roma, afër autolarjes “.....” i pandehuri A.M., i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit T.Th., në atë mënyrë pasi që ishte duke pirë kafe me shokun e tij A.T., në restorantin e maketit “.....” me te ishte edhe vajza e tij 7 vjeçare U.M, pas disa minutash vajza kërkon që të shkon në shtëpi dhe i pandehuri e lejon, kur i pandehuri kthehet në shtëpi e pyet nënën e tij se ku është vajza, nëna e pandehurit i thotë se nuk kishte ardhur vajza në shtëpi, dhe kur i pandehuri e thirr me telefon vajzën e tij, ajo i përgjigjet se është me T.T., i pandehuri menjëherë del nga shtëpia dhe i sheh vajzën e tij me T.T., kur e pyet vajzën e tij se ç ‘bënin, vajza i përgjigjet se T.Th., e ka ftuar të shkoj në shtëpinë e tij për ta rregulluar biçikletën, i pandehuri menjëherë, i afrohet të dëmtuarit T.Th., njëjtin e godet me grushte e shqelma më pjesë të ndryshme të trupit, si pasojë e kësaj i dëmtuari T.Th., dëmtime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, si gjak mbledhje nënëkurore dhe ndrydhje të indeve të buta përreth syrit të djathtë, të përshkruar si në akt ekspertimin mjeko-ligjor nga eksperti mjeko-ligjor Dr. F.B., e datës 18.02.2021.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 46, 47, 48,49, 69, 70, 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë shumen prej 20€, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari T.Th., nga Prizreni, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.2033-3/20, të datës 09.03.2021, kundër të akuzuarit A.M., nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

I akuzuari A.M., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: pas leximit të aktakuzës e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është penduar për këtë veprim, dhe se ngjarja në ditën kritike ka qenë një moment i çastit.

Prokurori i shtetit Musli Gashi, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që pranimi ka mbështetje të plotë në provat dhe materialet të cilat përmban aktakuza dhe është bërë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të KPPRK-së, dhe duke pasur parasysh rrethanat specifike dhe fazën në të cilën i pandehuri e pranon fajësinë, propozon gjyqtarit gjykues që me rastin e matjes së dënimit dhe llojit të lartësisë së dënimit të ketë parasysh si rrethanë posaçërisht lehtësuese

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e

çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se i akuzuari A.M., me dashje ka kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të Aktgjykimit.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 185 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale lëndimi të lehtë trupor e kryen: “Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor”, ndërsa nën paragrafi 1.4 ka përcaktuar se “kur kemi dëmtim të përkohshëm të shendit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar edhe në gjendjen e vërtetuar faktike, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura, e ka shpallur fajtor të akuzuarin A.M., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është mbajtës i familjes, baba i 1 fëmijëve, pendimin e tij, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, fakti se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë si dhe duke mos gjetur rrethana rënduese, gjykata ka ardhur në përfundim se këto janë rrethana, që tregojnë me dënimin e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe tek i akuzuarit me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale dhe se dënimi i shqiptuara sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko - civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 par.2 të KPP-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.289/21, me datë 27.03.2024

Zyrtari ligjor
gjykues
Amar Hoxha

Gjyqtari i vetëm
Arlind Sharani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.